

REPUBLICA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e Infermierëve të Kosovës Komora medicinskoh sестара, бабика и осталих здравствених стручњака Косова Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARRIV ARRIV ARCHIVE		
Nr. Prot. Braj. prot. Prot. no	Nr. i fag. Ser. str. No	Data: Datumi
507	-1-	12.06.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues të datës 02.05.2019 Kryetari i OIK-ut shpallë:

FTESË PUBLIKE MBI SHPREHJEN E INTERESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË OIK-UT

Ftojmë kompanitë audituese të licencuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), që të paraqesin ofertat e tyre për: **Auditimin e pasqyrave financiare të Odës së Infermierëve të Kosovës për vitet 2016, 2017 dhe 2018.**

Objektivat dhe fushëveprimi i punës:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që të mundësojë auditorin të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar dhe të ardhurave e shpenzimeve për periudhën kontabël. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme në lidhje me atë nëse pasqyrat financiare nuk janë të pavërteta. Auditimi përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Kjo gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ofertat e paraqitura duhet të përmbajnë:

- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur;
- Përvojat në auditimin e institucioneve të tjera të ngjashme me OIK;
- CV – të dhe referencat për stafin dhe përvojat e tyre dhe
- Ofertën financiare.

Përzgjedhja e auditorit të pavarur bëhet nga ana e Këshillit Drejtues të OIK-ut pas mbylljes së afatit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet pranë zyrave të OIK-ut në formë fizike nga ora 10:00 deri në ora 14:00

Afati i aplikimit është 5 ditë pune nga dita e publikimit në webfaqen e OIK-ut, <http://oik-ks.org/>.

Data e Publikimit:

12.06.2019, Prishtinë



Kryetari i OIK-ut

Naser Rrustemaj

Naser Rrustemaj